

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6393
E shtunë, 21 gusht 2021
çmimi 0.40 €

Kosova pranon
35 000 vaksinat e para
nga ShBA-ja **FAQE 4**



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE (KQZ) KA NJOFTUAR SE KA NISUR
PROCESI I VERIFIKIMIT PËR KANDIDATËT PËR KRYETAR KOMUNE
DHE PËR KANDIDATËT PËR ASAMBLE **FAQE 3**

KQZ-JA NIS VERIFIKIMIN E KANDIDATËVE PËR KRYETAR DHE PËR ASAMBLE



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka njoftuar se ka nisur procesin e verifikimit për të gjithë kandidatët për kryetar komune dhe për kandidatët për asamble

komunale. Në një konferencë për media zëdhënasi i KQZ-së, Valmir Elezi, ka thënë se deri më tani janë dërguar në institucionet përgjegjëse për verifikim 3

205 emra, kandidatë për zgjedhjet lokale të 17 tetorit. Ndërsa, sipas tij, edhe 2 000 emra të tjerë do të dërgohen së shpejti për verifikim

AKTUALE



**BLINKENI DHE RAMA DISKUTOJNË
PËR STREHIMIN E AFGANËVE** **F.2**

**PO JETËSOHET KËRKESA
E AKK-SË, FUNKSIONALIZIMI
I GRANTIT TË KATËRT
PËR KOMUNA** **F.7**

**SERBIA NDËRTON OBJEKTIN E
"UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS
NË MITROVICË"** **F.5**

EKONOMI



**SHPENZIMET E DIASPORËS,
DERI NË 500 MILIONË EURO** **F.8**

**MINISTRI PEÇI MERR PJESË NË
KONFERENCËN NDËRKOMBËTARE
MINISTRORE NË
SLLOVENI** **F.8**

SPORT



**REJA: PRES KONFIRMIME
NGA KOMBËTARJA,
SHQIPTARËT MË DUAN** **F.12**

**Mësimi
fillon më
1 shtator
në
objekte
shkollore**



**Sërish rekord rastesh me
Covid-19 në Kosovë** **FAQE 5**

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.PK.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Blinken dhe Rama diskutojnë për strehimin e afganëve

PRISHTINË, 20 GUSHT - Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken dhe kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, kanë zhvilluar një bisedë telefonike më 18 gusht në lidhje me ofertën e Shqipërisë për t'i strehuar përkohësisht qytetarët afganë. Në një njoftim të lëshuar të enjten nga zëdhënësi i Departamentit të Shtetit, Ned Price, thuhet se sekretari Blinken ka falënderuar "kryeministrin Rama për vazhdimin e traditës krenare të Shqipërisë për strehimin e njerëzve që kanë nevojë".

Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut janë tri vendet e Ballkanit Perëndimor të cilat kanë shprehur gatishmërinë të pranojnë një pjesë të punëtorëve afganë që kanë punuar me forcat e huaja, përfshirë ato amerikane, por të cilët duhet të evakohen nga Afganistani për shkaqe sigurie dhe derisa atyre t'u përfundojnë

procedurat e marrjes së vizës amerikane.

Të premtën në Shkup pritet të arrijë grupi prej 450 afganëve që autoritetet maqedonase do të strehojnë. Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka thënë për gazetën italiane "Il Foglio" se Tirana zyrtare do të strehojë 2 000 deri në 3 000 afganë, por ende është e paqartë se kur ata do të arrijnë në Shqipëri.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, i ka thënë BBC-së më 18 gusht, se brenda dy ose tri ditësh do të dihet data e saktë se kur do të arrijë grupi i parë i afganëve në Kosovë. Ajo ka thënë se numri i përgjithshëm i atyre që do të strehojë Kosova po diskutohet me partnerët amerikanë.

Më 15 gusht talebanët morën kontrollin e Kabulit dhe thanë se së shpejti do të formojnë një qeveri gjithëpërfshirëse, të bazuar në parimet islame.

Mijëra afganë ia kanë mësyre



aeroportit të Kabulit dhe po mëtojnë që të largohen nga Afganistani, nga frika nga talebanët.

Departamenti Amerikan i Shtetit ka shpallur një program të ri i cili

u mundëson mijëra afganëve mundësinë të zhvendosen si refugjatë në ShBA.

Mijëra afganë që do të jenë pjesë e këtij programi duhet të barten në një shtet të tretë dhe të presin

për 12 deri në 14 muaj derisa të analizohet gjithë aplikacioni.

Gjatë bisedës telefonike, Blinken dhe Rama kanë riafirmuar partneritetin e ngushtë midis dy vendeve.

Britania, Franca dhe Gjermania shprehin shqetësim për pasurimin e uraniumit nga Irani

LONDËR, 20 GUSHT - Britania, Franca dhe Gjermania, tri shtetet nënshkruese të marrëveshjes bërthamore të vitit 2015 ndërmjet Iranit dhe fuqive botërore, kanë shprehur shqetësim të thellë mbi raportin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, që thotë se Teherani ka rritur prodhimin e metalit të uraniumit dhe ka rritur në përgjithësi pasurimin e uraniumit, që paraqet shkelje të marrëveshjes. "Ne, qeveritë e Francës, Gjermanisë dhe Mbretërisë së Bashkuar, me shqetësim të thellë kemi parë raportimin e fundit të Agjencisë Ndërkombëtare për Energji Bërthamore që konfirmon se Irani për herë të parë ka prodhuar metal të uraniumit deri në 20 për qind të pastër dhe



ka rritur ndjeshëm kapacitetet e prodhimit të uraniumit të pasuruar deri në 60 për qind", thuhet në deklaratën e përbashkët të ministrave të Jashtëm të të tri shteteve.

Agjencia Ndërkombëtare për

Energji Bërthamore tha më 16 gusht se Irani ka prodhuar për herë të parë 200 gramë të metalit të uraniumit të pasuruar deri në 20 për qind, ndërkaq më 17 gusht, në një raport tjetër, tha se Irani po e pasuron uraniumin

deri në 60 për qind pastërti, duke përdorur centrifugat në uzinën bërthamore Natanz.

Sipas marrëveshjes të vitit 2015, Teherani është zotuar se nuk do të prodhojë metal të uraniumit, material që mund të përdoret për të prodhuar bombë bërthamore. Por, më herët, gjatë këtij viti, Irani ndërmori një sërë hapash që shkelën marrëveshjen e vitit 2015, pasi ish-presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, e tërhoqi Uashingtonin nga marrëveshja dhe rivendosi sanksione. Irani më pas tha se po bënte hulumtime për metalin e uraniumit për të krijuar një reaktor të ri.

Presidenti amerikan Joe Biden tha se dëshiron që të kthehet në marrëveshje, por bisedimet në

Vjenë, të ndërmjetësuar nga evropianët, për ta kthyer Uashingtonin dhe Teheranin në marrëveshje, kanë ngecur.

Irani më 18 gusht ka konfirmuar raportin e Agjencisë Ndërkombëtare për Energji Bërthamore për pasurimin e uraniumit deri në 60 për qind pastërti, duke thënë se veprimet janë përgjigje ndaj sanksioneve amerikane.

Për prodhimin e armëve bërthamore kërkohet që uraniumi të pasurohet deri në 90 për qind dhe, po ashtu, kërkohen edhe një sërë hapash të tjerë teknikë që të mund të prodhohet një bombë bërthamore. "Irani duhet të ndalë këto aktivitete që janë në kundërshtim me marrëveshjen", thanë Britania, Franca dhe Gjermania.

ShBA: Avionët luftarakë po fluturojnë mbi Kabul për të ofruar siguri për evakuimet

KABUL, 20 GUSHT - Avionët luftarakë amerikanë kanë fluturuar mbi Kabul për të ofruar siguri për operacionet e evakuimit që po zhvillohen në kryeqytetin afgan. Avionët e armatosur nuk kanë kryer "fluturime të ulëta" mbi qytet, por kanë kryer operacione "mbikëqyrëse", ka pohuar zëdhënësi i Pentagonit, John

Kirby.

Gjeneralmajori i ushtrisë amerikane, William Taylor, ka thënë se dhjetëra porta të aeroportit në Kabul tani janë të hapura dhe deri më tani, rreth 7 000 persona janë evakuuar. Ai ka theksuar se tani ushtria ka më shumë se 5 200 trupa në aeroportin e Kabulit që po ndihmojnë në procesin e

evakuimit.

Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, ka thënë se forcat amerikane do të qëndrojnë derisa të gjithë amerikanët do të largohen, edhe nëse kjo nënkupton që do të shkelet afati i 31 gushtit, kur është thënë se do të përfundojë tërheqja e trupave nga Afganistani.



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE (KQZ) KA NJOFTUAR SE KA NISUR PROCESI I VERIFIKIMIT PËR KANDIDATËT PËR KRYETAR KOMUNE DHE PËR KANDIDATËT PËR ASAMBLE

KQZ-ja nis verifikimin e kandidatëve për kryetar dhe për asamble

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka njoftuar se ka nisur procesin e verifikimit për të gjithë kandidatët për kryetar komune dhe për kandidatët për asamble komunale. Në një konferencë për media zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, ka thënë se deri më tani janë dërguar në institucionet përgjegjëse për verifikim 3 205 emra, kandidatë për zgjedhjet lokale të 17 tetorit. Ndërsa, sipas tij, edhe 2 000 emra të tjerë do të dërgohen së shpejti për verifikim

**EPOKA
ERE****Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 20 GUSHT - Zëdhënësi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Valmir Elezi, ka mbajtur sot një konferencë për media lidhur me procesin e verifikimit të kandidatëve nëse janë në përputhje me nenin 29 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Ai ka bërë me dije se i janë drejtuar Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, Ministrisë së Punëve të Jashtme, Ministrisë së Mbrojtjes dhe Doganës së Kosovës lista me emrat e 3 205 kandidatëve që u takojnë subjekteve të ndryshme politike. "Janë dërguar në institucione të ndryshme shkresa të veçanta nga të cilat, në bazë të fushës së përgjegjësisë që mbulojnë, është kërkuar konfirmimi i përshtatshmërisë së kandidatëve me Nenin 29 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Këtyre shkresave i është bashkangjitur edhe lista me emrat e 3 205 kandidatëve që u takojnë subjekteve të ndryshme politike dhe të cilët kanë kërkuar nga KQZ-ja që të certifikohen për

pjesëmarrje në zgjedhje. Edhe rreth 2 000 emra të tjerë do të dërgohen së shpejti në këto institucione", ka thënë Elezi.

Ai ka theksuar se në nenin 29 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme janë të listuar të gjitha rastet kur një person nuk mund të certifikohet si kandidat prandaj, sipas zëdhënësit të KQZ-së, është kërkuar për secilin kandidat, nga secili prej këtyre institucioneve, të bëjnë verifikimin sipas fushës së përgjegjësisë që mbulojnë. "Këto shkresa janë dërguar në institucione të ndryshme, siç janë: Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme, Agjencia e Kosovës për Inteligjencë, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Mbrojtjes dhe Doganës së Kosovës", ka thënë Elezi.

Ai ka bërë me dije se, sipas planit operacional të miratuar nga KQZ-ja, është planifikuar që deri më 23 gusht të përfundojë procesi i dërgimit të kërkesave në këto institucione për verifikim të kandidatëve. "Sipas planit operacional, do të presim përgjigje nga këto institucione më së largu deri më 24 gusht", është shprehur Elezi, duke shtuar se pas pranimit të



përgjigjeve, Zyra për Regjistrim të Partive Politike dhe Certifikim do t'i përgatisë rekomandimet lidhur me certifikimin ose jo të ndonjë kandidati, ndërsa KQZ-ja do të marrë vendimet më së largu deri më 1 shtator.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka njoftuar se për pjesëmarrje në zgjedhjet lokale të 17 tetorit kanë aplikuar 94 subjekte politike, prej tyre 32 parti, një koalicion, 35 iniciativa qytetare dhe 26 kandidatë të pavarur.

Zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, ka njoftuar se numri i përgjithshëm i kandidatëve që kanë aplikuar është 4 920, prej tyre 165 për kryetarë komunash

dhe 4 757 për kuvende komunale.

Bashkimi Evropian (BE) i është përgjigjur pozitivisht ftesës së presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani, që një mision evropian ta bëjë monitorimin e zgjedhjeve lokale në Kosovë të caktuara për 17 tetor. Në muajin qershor presidentja Osmani kishte kërkuar nga presidenti i Parlamentit Evropian, David Sassoli, si dhe përfaqësuesi i lartë i BE-së për politikë të jashtme dhe siguri, Joseph Borrell, që të dërgojnë një mision monitorimi të zgjedhjeve.

Presidenca ka njoftuar më 18 gusht se ka pranuar përgjigjen nga ana e këtyre dy zyrtarëve në

të cilat thuhet se Parlamenti Evropian konfirmon gatishmërinë për të marrë pjesë në monitorimin e zgjedhjeve në Kosovë, ndërsa përfaqësuesi i lartë, Borrell, do ta bëjë emërimin e shefit të misionit. "Për dallim nga zgjedhjet e fundit parlamentare, në të cilat Misioni i BE-së për vëzhgimin e zgjedhjeve është përbërë nga një numër i vogël ekspertësh, në zgjedhjet lokale të vitit 2021 BE-ja do të jetë e pranishme me mision të plotë të vëzhgimit të zgjedhjeve në Republikën e Kosovës deri në certifikimin e rezultatit zgjedhor", thuhet në njoftimin e zyrës së presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani.

Qytetarët e Kosovës nuk kanë kufizime për hyrje në Mal të Zi



PRISHTINË, 20 GUSHT (ER) - Mali i Zi ka njoftuar se hyrja e qytetarëve të rajonit në këtë vend mbetet i pakushtëzuar dhe se në kufijtë malazezë nuk kërkohet asnjë dokument që lidhet me pandeminë, përfshirë testin e Covidit apo certifikatën e vaksinimit. Hyrja e pakushtëzuar vlen për banorët e Kosovës, Shqipërisë, Bosnje dhe Hercegovinës, Kroacisë dhe Maqedonisë së Veriut si dhe për qytetarët malazezë që udhetojnë nga këto vende. Qendra Kombëtare për Menaxhimin Kufitar të Kosovës,

në faqen e saj në "Facebook", ka njoftuar për vendimin e Malit të Zi, duke thënë se "për të hyrë në Malin e Zi secili qytetar duhet të ketë me vete një nga katër provat, dëshmi të vaksinimit, testin negativ apo atë antigjen". Kjo qendër nuk kishte sqaruar në njoftimin e saj se ky rregull nuk vlen për qytetarët e Kosovës. Postimi më pas është fshirë nga faqja e këtij institucioni.

Në fakt, sipas Institutit të Shëndetit Publik në Mal të Zi, kufizimet në qarkullim vlejné për të gjitha vendet e tjera,

përveç atyre të rajonit ku përfshihet edhe Kosova. "Nëse një person nuk ka asnjë nga këto katër dëshmi (vaksinimi me një ose të dyja dozat, një test negativ PCR jo më i vjetër se 72 orë, dëshmi se e ka kaluar Covid-19 ose një test i shpejtë antigjen negativ jo më i vjetër se 48 orë), ai dërgohet në një izolim katërmëdhjetëditor që mund të përfundojë pas ditës së gjashtë të hyrjes në Mal të Zi përmes një testi PCR negativ", ka thënë drejtori i Institutit, Igor Galiq. Masat e reja do të hyjnë në fuqi më 24 gusht.



Mësimi fillon më 1 shtator në objekte shkollore

Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit (MASHTI) ka bërë me dije se rritja e numrit të rasteve me Covid-19 nuk do të ndikojë në fillimin e vitit të ri shkollor. Zyrtarët e kësaj ministrie kanë treguar se mësimi do të fillojë më 1 shtator në objektet shkollore, duke thënë se janë duke i bërë të gjitha përgatitjet për një gjë të tillë. Opozita ka shprehur skepticizëm rreth këtyre përgatitjeve. Sipas saj, MASHTI po e dështon edhe një vit të ri shkollor për shkak të keqmenaxhimit të pandemisë, ndërsa mësimdhënësit janë shprehur të gatshëm për fillimin e mësimin në objekte shkollore

Muhamet KOCI

Prishtinë, 20 gusht - Pavarësisht prej rritjes së madhe të numrit të rasteve me Covid-19, Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit (MASHTI) ka njoftuar se fillimi i vitit të ri shkollor do të nisë me kohë.

Zëvendësministrja e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit, Edona Maloku-Bërdyna, ka bërë me dije se kjo ministri është duke i bërë të gjitha përgatitjet që ky vit shkollor të nisë më 1 shtator.

Në konferencën për media, duke folur për përgatitjet që janë duke u bërë për fillimin e vitit të ri shkollor 2021/22, Maloku-Bërdyna ka thënë se në bashkëpunim me drejtoritë komunale të arsimit do të sigurohen që shkollat t'i plotësojnë kushtet si nga ana infrastrukturore, por edhe në bazë të rekomandimeve të IKShPK-së që mësimdhënësit të

jenë të vaksinuar. “Na ndajnë edhe pak ditë para fillimit të vitit të ri shkollor. Ne jemi duke bërë përgatitjet që mësimi të fillojë me kohë, pra më 1 shtator”, ka thënë ajo.

Maloku-Bërdyna ka treguar se është dyfishuar numri i personelit arsimor të vaksinuar në dy javët e fundit. “Numri i personelit arsimor të vaksinuar bashkë me stafin e arsimit të lartë dhe studentët është 55 094, krahasuar me dy javë më parë, ku totali ka qenë 29 878, tani kemi 55 094. Kemi dyfishim të vaksinuarve gjatë dy javëve”, është shprehur ajo, duke shtuar se MASHTI do t'i përkrahë shkollat me maska dhe dezinfektues.

Për përgatitjet e fillimit të vitit të ri shkollor ndryshe mendon opozita. Anëtari i Kryesisë i Partisë Demokratike të Kosovës, Muzafer Shala, ka akuzuar MASHTI-n se po e dështon edhe një vit të ri shkollor për shkak të keqmenaxhimit me pandeminë.

Në një konferencë për media ai

ka thënë se kjo ministri nuk i ka bërë përgatitjet e duhura për fillimin e vitit të ri shkollor. “PDK-ja e konsideron jashtëzakonisht të papranueshme, zhgënjyese dhe dështim fund e krye të qeverisë dhe të Ministrisë së Arsimit që nuk ka arritur t'i bëjë përgatitjet e duhura që viti i ri shkollor të fillojë më 1 shtator tani që situata me pandeminë Covid-19 është rënduar dhe numri i rasteve të infektuara me virusin ‘Delta’ po rritet çdo ditë”, ka thënë ai.

Shala i ka bërë thirrje Ministrisë së Arsimit dhe të gjitha institucioneve përgjegjëse që ta marrin seriozisht situatën me pandeminë dhe përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor, në të kundërtën do të zbehet besimi i mësuesve, nxënësve dhe prindërve në sistemin arsimor të vendit tonë në këtë krizë pandemie. “Ministria e Arsimit nuk është fare e informuar për gjendjen në terren. Në vend të përgatitjeve intensive, ata e kaluan pushimin veror në

bregdet dhe sallone dasmash. Me këtë situatë të rënduar e ardhmja e fëmijëve tanë është duke u shkatërruar, rrjedhimisht edhe zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik dhe social”, ka deklaruar Shala.

Rreth përgatitjeve për fillimin e procesit mësimor është deklaruar edhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, e Shkencës dhe e Kulturës e Kosovës (SBASHK).

Kryetari i kësaj sindikate, Rahman Jasharaj, ka thënë për “Epokën e re” se e vërteta për këto përgatitje do të dihet shumë shpejt. “Në takimin që kishim këtë të martë me grupin punues të MASTI-t lidhur me Udhëzimin Administrativ për Kalendarin shkollor për vitin e ri shkollor na është thënë se ata konsiderojnë, bazuar në raportet nga drejtoritë arsimore, se janë bërë përgatitjet e duhura për nismë të mbarë të vitit të ri shkollor dhe urojmë të jetë kështu. Por, nga praktikat e viteve të kaluar, ka nga DKA-të që gjenden nuk e paraqesin reale”, ka thënë Jasharaj.

Ai ka treguar se nga java e ardhshme vetë kjo sindikatë do të mbledhë informata për këtë proces. “Ne nga e hëna do të mbledhim shënime të sakta nga kryetarët e shoqatave sindikale nga të gjitha shkollat e Kosovës dhe nga kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe do të bazohemi në ato informata sepse gjithmonë kanë qenë

korrekte dhe të sakta dhe pastaj, në bazë të tyre, edhe do të dalim publikisht me vlerësimin lidhur me atë se janë dhe sa janë përgatitur institucionet arsimore për fillimin e vitit të ri shkollor. Institucionet duhet ta kenë të qartë se përgatitjet që janë bërë në të kaluarën, kur nuk kemi pasur probleme shtesë me Covidin, nuk janë të mjaftueshme nëse nuk janë bërë përgatitje e angazhime shtesë, ngaqë tani versioni i ri i Covidit, pra ‘Delta’, po prek edhe fëmijët dhe moshat e reja, që në vitin e kaluar shkollor nuk ishte kështu, prandaj përgatitjet duhet të jenë maksimale”, ka deklaruar Jasharaj.

Ai ka theksuar se mësimdhënësit janë të gatshëm që mësimin ta fillojnë në objektet shkollore. “E vërteta se a janë dhe sa janë të përgatitura institucionet arsimore për të filluar mbarë viti i ri shkollor do të dalë shpejt në shesh. Neve na gëzon fakti se punëtorët e arsimit kanë dëgjuar apelin tonë dhe është shtuar shumë numri i të vaksinuarve, po ashtu krenohemi me gatishmërinë e tyre që mësimin ta nisin në objekte shkollore”, ka thënë Jasharaj.

Zyrtarët më të lartë qeveritarë vazhdimisht kanë thënë se vaksinimi i mësimdhënësve dhe respektimi i masave kundër Covidit është domosdoshmëri për ta mundur fillimin e vitit të ri shkollor me prani fizike.

Kosova pranon 35 000 vaksinat e para nga ShBA-ja

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 20 GUSHT - Përmes një ceremonie të organizuar të premtën në ambientet e QKUK-së, Kosova ka pranuar 35 100 doza të vaksinës "Pfizer" nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës nga mbi gjysmë milioni që pritet të vijjnë në vazhdim. Me këtë është përmbushur zotimi i presidentit Joe Biden për t'i ndihmuar partnerët anembanë botës në luftën kundër Covid-19. Kjo paraqet donacionin më të madh të vaksinës kundër Covid-19 që ndonjë vend apo organizatë ia ka dhuruar Kosovës. Me këto doza, Qeveria e Kosovës do të ketë mundësi t'i vaksinonjë dhe t'i mbrojnë qytetarët e saj, duke lëvizur për 20 për qind më afër arritjes së qëllimit të saj të përgjithshëm të vaksinimit. "Dërgesa e sotme është pjesë e përkushtimit të presidentit Biden për t'i ndarë dozat e vaksinës Covid-19 nga furnizimet vendore amerikane për t'i mbështetur nevojat globale. Pasi që asnjë vend nuk mund ta mposhtë Covid-19 vetëm, në qershor Shtetet e Bashkuara fillimisht u përkushtuan për të ndarë 80 milionë doza vaccine me botën. Që nga 3 gushti ne kemi dhuruar dhe dërguar mbi 110 milionë doza në më shumë se 60 vende, dhe ky është vetëm fillimi. Sikurse ka thënë presidenti Biden: 'Po i ndajmë këto doza jo për të siguruar favore apo për të nxjerrë koncesione. Po i ndajmë këto vakcina për të shpëtuar jetë dhe për ta udhëhequr botën që t'i japim fund pandemisë"', është theksuar në komunikatën e Ambasadës së ShBA-së. Duke folur gjatë ceremonisë së arritjes së vaksinave, ambasadori



amerikan Philip S. Kosnett ka thënë se vaksinat bëjnë punë vetëm nëse qytetarët vaksinohen. "Shumë njerëz ende besojnë se vakcina është e panevojshme ose nëse janë infektuar dhe i kanë mbijetuar Covidit, që nuk do të sëmuren sërish. Kjo, thjesht, nuk është e vërtetë, veçanërisht në vazhdimin e rritjes dramatike të rasteve të shkaktuara nga varianti 'Delta'. Prandaj, ju lutemi, vaksinohuni për ta mbrojtur veten, familjet dhe komunitetin tuaj", ka thënë Kosnett.

Sërish rekord rastesh me Covid-19 në Kosovë

Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se, sipas të dhënave nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës, prej 11 814 testeve, 2 250 qytetarë kanë rezultuar pozitivë të premtën me virusin Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit janë shënuar edhe katër raste të vdekjes. Të premtën janë shënuar edhe

154 qytetarë, derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 106 700. Sipas njoftimit, grupmosha me më së shumti raste të reja është ajo 20-29 vjeç me 543 raste, pasuar nga 30-39 vjeç me 476 raste. Komuna me më së shumti raste të reja është Prishtina, ku janë regjistruar 362 raste të reja. Në total numri i rasteve aktive me

Covid është 16 341. Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e fundit janë dhënë 22 245 doza të vaksinës kundër Covid-19. Sipas MSh-së, prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 666 476 doza të vaksinës. Deri më sot 227 581 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë.

Serbia ndërton objektin e 'Universitetit të Prishtinës në Mitrovicë'



MITROVICË, 20 GUSHT - Serbia ka filluar ndërtimin e objektit të përhershëm të të ashtuquajturit "Universiteti i Prishtinës me seli të përkohshme në Mitrovicë". Investimi mbi 6 milionë euro do të bëhet nga Qeveria e Serbisë përmes Zyrës për Kosovën që funksionon në kuadër të saj. Drejtori i kësaj zyre, Petar Petković, hodhi gurthemelin për ndërtimin e universitetit të premtën (20 gusht) në Mitrovicën Veriore. "Ky është gurthemel i harmonisë, i unitetit të popullit tonë në Kosovë, dhe për këtë sot ne jemi të bashkuar siç ishim dhe do të jemi: edhe Lista Serbe ashtu edhe universiteti ynë dhe shteti i Serbisë. Populli ynë ka të ardhme

vetëm përmes këtij uniteti, siç ka thënë edhe presidenti Vuçiq", ka thënë Petković. Ndërtesa do të ketë 10 575 metra katrorë, me kapacitet për pranim të 10 000 studentëve, ndërsa në kuadër të këtij universiteti do të funksionojnë: Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Matematikës, Fakulteti i Drejtësisë dhe Fakulteti Ekonomik. Mitrovica e Veriut është komunë e banuar me shumicë serbe në veri të Kosovës, ku autoritetet serbe kanë zhvendosur, siç e quajnë ata, Universitetin e Prishtinës, pas përfundimit të luftës në vitin 1999. Studimet aty zhvillohen sipas planprogramit të Republikës së Serbisë. (Rel)

Më 23 gusht fillon dezinfektimi hapësinor në territorin e Ferizajt

FERIZAJ, 20 GUSHT (ER) - Komuna e Ferizajt ka njoftuar se më 23 gusht, me fillim nga ora 19:30, fillon implementimi i projektet "Dezinsektimi hapësinor (eliminimi i insekteve, mushkonjave dhe mizave) në territorin e kësaj komune.

Dezinsektimi hapësinor do të kryhet në të gjithë qytetin, duke nisur nga Parku i Lirisë dhe vazhdon në rrugën "Brahim Ademi", ku përfshihen edhe rrugët rreth Zonës së FSK-së, te Palestra e Sporteve, rrugët "Naim Beka", "Epojeja e Jezercit", "Zenel

Hajdini", "Enver Topalli", Tregu i Gjelbër deri në fshatin Nikadin, për të vazhduar në anën lindore të qytetit që përfshinë rrugët "Ahmet Kaçiku", "Rexhep Bislimi", "Vëllezërit Gërvalla", "Kadri Zeka", "Driton Islami", "Reçaku" deri në magjistrale.

Ndërkaq më 24 dhe 25 gusht dezinfektimi do të bëhet edhe në të gjitha fshatrat e komunës së Ferizajt. "Në rast të motit me shi dhe erërave të forta, shtyhet orari deri në ditën e ardhshme me mot të mirë dhe vijon sipas orarit të paraparë", ka njoftuar komuna e Ferizajt.



Haziri: Gjendja me Covid është alarmante, duhet vaksinim masiv i qytetarëve

Gjilan, 20 gusht (ER) - Kryetari i komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, pas takimit me komitetin për menaxhimin e pandemisë Covid-19, në bazë të vlerësimeve ndërinstitucionale, ka vlerësuar një gjendje të tendosur dhe kronikë e zezë, për shkak se janë aktive 1 063 raste me Covid-19. "Ky është numri më i madh i të infektuarve në Komunën e Gjilanit dhe deri më tani 150 qytetarë kanë humbur jetën. Kjo është gjendje shumë e rëndë dhe kërkon bashkëpunim të përgjithshëm, respektim të masave mbrojtëse dhe vaksinim. Në regjistrin e vaksinimit konfirmohet se deri mbrëmë janë dhënë 34 475 vakcina. Është e vetmja mënyrë për rritje të imunitetit kolektiv, prandaj apeloj që të vaksinoheni sa më shumë, sepse kështu mund të tejkalojmë më lehtë infeksionin. Vetëm me vaksinim mund ta ruajmë jetën, familjen dhe vendin e punës", ka thënë Haziri.

Ai i ka bërë thirrje edhe Qeverisë së Kosovës që orari i vaksinimit të jetë 24 orë, 7 ditë në javë, me



dinamikë të re dhe më intensive, me mobilizim më të madh shtetëror, për t'u dhënë mundësi komunave për menaxhim në mënyrë që ta përmbyllin vaksinimin. "Gjilani ka mundësi për të organizuar edhe lokacionin edhe kapacitetet, mirëpo qeveria këtë shërbim duhet ta bartë në komuna si kompetencë. Ne nga

palestra e sporteve, ku është duke ndodhur vaksinimi tani, mund të aktivizojmë edhe tri qendra të tjera për të vaksinuar sa më shumë qytetarë", ka theksuar Haziri.

Ai u ka bërë thirrje qytetarëve që masat kundër Covidit të zbatohen nga të gjithë në përpikëri, sipas urdhërësës së qeverisë, që

parasheh edhe anulimin e ahengjeve, dasmave dhe organizimeve të tilla, duke bërë kështu që edhe festivali "Mish-mish", i paraparë për nesër në bazë të kalendarit për mërgatën, shtyhet për një datë tjetër, për shkak të kushteve dhe masave të reja që janë publikuar nga niveli qendror.

Në bazë të statistikave të përgjithshme, raste aktive me Covid-19 në Gjilan janë 1 063 raste, të shëruar janë 6 539 raste, fatkeqësisht jetën e kanë humbur 150 qytetarë, kurse numri total i rasteve pozitive deri më sot është 7 753 raste, ndërsa të shtrirë në spitale me Covid janë 72 pacientë.

Latifi jep mirënjohje për stafin shëndetësor, policët, inspektorët, zjarrfikësit dhe punëtorët e administratës



RAHOVEC, 20 GUSHT (ER) - Në Ditën Botërore të Humanizmit, në emër të Komunës së Rahovecit, kryetari i komunës, Smajl Latifi, ka dhënë mirënjohje për stafin shëndetësor, policët, inspektorët, zjarrfikësit, punëtorët e administratës, të Qendrës për Punë Sociale dhe donatorët për kontributin e dhënë në periudhën e vështirë të pandemisë. "Pandemia na ka goditur të gjithëve, rëndë! Dhe në Rahovec, ashtu si në çdo vend të botës, heronjtë e vërtetë të luftës ndaj pandemisë ishin të gjithë

punëtorët esenciale, duke filluar nga stafi shëndetësor, policët, inspektorët, zjarrfikësit, pastaj punëtorët e administratës, të Qendrës për Punë Sociale dhe donatorët. Ata nuk kursyen asgjë nga vetja për të kontribuar në një mënyrë apo tjetër. Andaj, sot, në Ditën Botërore të Humanizmit, në emër të Komunës së Rahovecit, kam ndarë mirënjohje për të gjithë këta që kanë dhënë shumë nga vetja që ne ta kalojmë sa më lehtë këtë periudhë të vështirë", ka thënë kryetari Latifi.

21 makina pastrimi për shkollat e komunës së Podujevës

PODUJEVË, 20 GUSHT (ER) - Në kuadër të projekteve për krijimin e kushteve sa më të mira për zhvillimin e procesit mësimor, shkollat e komunës

së Podujevës do të pajisen me 21 makina moderne pastrimi. Furnizimi i shkollave me makina të reja pastrimi bëhet me qëllim të lehtësimin dhe

avancimit në aspektin e mirëmbajtjes së objekteve shkollore dhe do të ndikojë drejtpërdrejt në ngritjen e pastërtisë në institucionet

arsimore. Edhe ky projekt po realizohet në kuadër të përgatitjeve për fillimin e vitit të ri shkollor 2021/2022.



Shërbimi Korrektues, masa të reja kundër Covidit

PRISHTINË, 20 GUSHT (ER) - Shërbimi Korrektues i Kosovës (SHKK) ka bërë me dije se në bashkëpunim me Departamentin Shëndetësor të Burgjeve, duke vlerësuar gjendjen me pandeminë në vend, ka marrë vendim për zbatim të masave kundër Covid-19. Sipas njoftimit të SHKK-së, secili pjesëtar i stafit i cili punon në institucione korrektuese dhe nuk është i vaksinuar, nga data 23 gusht, për të hyrë në punë, obligohet që çdo 7 ditë të sjellë test RT-PCR jo më të vjetër se 72 orë, ose test rapid jo më të vjetër se 48 orë.

Në njoftimin për media theksohet se përjashtim nga pika 1 bën ai pjesëtar i stafit i cili është në proces të vaksinimit, gjegjësit ka marrë dozën e parë dhe është në proces të marrjes së dozës së dytë dhe ai i cili është vaksinuar me të dyja dozat, ose ka ndonjë dokument përkatës që konfirmon se personi nuk është i infektuar ose ka fituar imunitet. Më tutje theksohet se secili i burgosur, i pavaksinuar, pas daljes nga institucioni, qoftë për vizitë në familje, gjykatë, trajtim mjekësor apo çfarëdo nevojë



tjetër, pas kthimit do të karantinohet për shtatë ditë. Gjithashtu, secili i burgosur i pavaksinuar, i cili pranohet në institucione korrektuese, do të karantinohet për shtatë ditë dhe në ndërkohë do t'i mundësohet vaksinimi brenda kësaj

periudhe. SHKK-ja ka theksuar se të gjithë vizitorët, mbrojtësit, monitoruesit, kompanitë kontraktuese dhe personat e tjerë të cilët nuk janë të vaksinuar, nuk mund të hyjnë në institucione korrektuese pa test RT-PCR jo më

të vjetër se 72 orë, ose test rapid jo më të vjetër se 48 orë, ose me një dokument përkatës që konfirmon se personi nuk është i infektuar ose ka fituar imunitet. Përjashtim nga pika 5 e këtij urdhri janë fëmijët nën moshën 18-vjeçare, nga të cilët kërkohet

respektimi i masave të tjera kundër Covidit që janë në fuqi. Sipas Shërbimit Korrektues të Kosovës, do të bëhet edhe dezinfektimi i plotë i hapësirave të brendshme dhe të jashtme në të gjitha institucionet korrektuese.

Po jetësohet kërkesa e AKK-së, funksionalizimi i grantit të katërt për komuna

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 20 GUSHT - Kërkesa e Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK) për formimin e grantit të veçantë për komuna do të funksionalizohet së shpejti. Granti i katërt për komuna ka për qëllim që niveli qendror t'i kanalizojë mjetet financiare për komuna përmes këtij granti.

Të premten është mbajtur takimi i përbashkët i AKK-së, Ministrisë për Financa, Pagesa e Transfere dhe aktorëve të tjerë, ku u vendos që ky grant të përfshihet në Projektligjin e Financave të Pushtetit Lokal. Takimi pati për qëllim përfshirjen në projektligj të grantit të katërt për komunat, siç është kërkuar edhe nga komunat përmes AKK-së. Drejtori ekzekutiv i AKK-së,

Sazan Ibrahim, ka theksuar se ky grant është shumë i rëndësishëm për komuna dhe realizimi i tij për pushtetin lokal në Kosovë do të jetë ndihmesë e madhe.

Duhet të theksohet se ky grant do të përdoret për financimin e projekteve kapitale të komunave, sipas përzgjedhjes së qeverive lokale, për zhvillim të gjithanshëm në sektorët si: turizmi rural, inovacioni, sportet, trashëgimia kulturore, arti, infrastruktura publike, sistemet e ngrohjes qendrore, furnizimi me ujë të pijshëm, mbarështimi dhe ripërtëritja e hapësirave të dëmtuara dhe trajtimi i ujërave të zeza.

Vlen të theksohet se tashmë për komunat do të jenë katër grante, ai i përgjithshëm, granti për arsim, për shëndetësi dhe tashmë ky granti i katërt për investime kapitale publike.

Nis hartimi i koncept-dokumentit për punëtorët e gjykatave dhe prokurorive

PRISHTINË, 20 GUSHT (ER) - Duke qenë i tillë dhe në pajtim me programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, është emëruar grupi punues për hartimin dhe finalizimin e koncept-dokumentit për nëpunësit civilë të gjykatave dhe prokurorive. "Grupi punues, duke qenë gjithëpërfshirës, mbi

bazën e analizave të gjendjes ekzistuese, si dhe aspekteve krahasuese, do të ofrojë opsione me qëllim që statusi i stafit të avancohet, bazuar në specifikat që ka sistemi gjyqësor dhe ai prokurorial, me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe efektivitetit", ka njoftuar Ministria e Drejtësisë. Kjo ministri ka theksuar se

mbetet thellësisht e përkushtuar për adresimin e sfidave jo të pakta që ka sistemi ynë gjyqësor dhe prokurorial. "Roli dhe rëndësia e stafit administrativ në këtë drejtim është tejet i rëndësishëm. Përfundimi i këtij procesi hapë rrugë që, sipas opsionit të rekomanduar, Ministria e Drejtësisë, në

koordinim me institucionet përkatëse, partnerët ndërkombëtarë si dhe përfaqësuesit nga shoqëria civile, të hartojë ligjin për stafin gjyqësor dhe atë prokurorial, si kërkesë e vazhdueshme e sindikatës dhe e stafit", është theksuar në njoftimin e Ministrisë së Drejtësisë.



Shpenzimet e diasporës, deri në 500 milionë euro

PRISHTINË, 20 GUSHT - Vetëm gjatë muajit korrik dhe gusht mbi 50 për qind ka pasur rritje të shitjes kompania 'Laberion' e cila merret me prodhimin e lëngjeve në Kosovë, thotë pronari i kësaj kompanie, Bashkim Osmani. Kjo rritje, shton ai, ka ardhur nga numri i madh i qytetarëve nga diaspora të cilët po kalojnë pushimet në Kosovë. "Diaspora bën shpenzime kur vjen në Kosovë dhe na krijon mundësi të zhvillimit të dukshëm ekonomik. Nga muaji qershor punojmë me dy ndërrime falë konsumit që rritet", thotë Osmani për "Radion Evropa e Lirë". Në vitin e kaluar në periudhën e njëjtë kohore, kompania 'Laberion' kishte shënuar rënie të shitjes mbi 20 për qind, pasi diaspora kishte anuluar vizitat në Kosovë për shkak të pandemisë me Covid-19. Sezoni i verës është koha kur qytetarët që jetojnë dhe punojnë jashtë vendit kthehen në Kosovë për t'i kaluar pushimet. Gjatë kësaj kohe shumë herë nuk arrin të gjesh taksit të lirë apo një vend në restorante apo kafene. Rugët, po ashtu, janë të ngarkuara me automjete. Bizneset raportojnë për rritje të madhe të konsumit.

Diaspora, infuzion për ekonominë e Kosovës

Lirim Krasniqi nga Organizata joqeveritare "Germin", organizatë kjo që merret kryesisht me çështje të diasporës, vlerëson se nga fundi i muajit qershor deri në fillim të muajit gusht rreth 1 milion

qytetarë nga diaspora kanë ardhur në Kosovë.

Ai tregon se në rastin më të mirë, shpenzimet e tyre gjatë sezonit të verës, sipas vlerësimeve të bëra, arrijnë shifrën e 500 milionë euro. "Sipas një vlerësimi që kemi bërë, në rastin më të keq të mundshëm, diaspora ka shpenzuar rreth 300 milionë euro gjatë vizitave që janë bërë në Kosovë gjatë muajve të verës. Në rastin më të mirë, ajo shifër mund të shkojë deri në 500 milionë euro. Cilido rast, është shifër e lartë dhe infuzion për ekonominë e Kosovës, sidomos në rrethana të pandemisë kur disa biznese kishin regjistruar humbje të mëdha për shkak të mbylljes së përkohshme nga masat Covid-19", thotë Krasniqi.

Përveç shpenzimeve që diaspora e Kosovës bën gjatë sezonit të verës, çdo vit Kosova pranon remitenca. Vetëm vitin e kaluar mjetet e ardhura nga diaspora kanë kapur vlerën prej 980.1 milionë eurosh.

Numër rekord i hyrjeve në Kosovë

Të dhënat zyrtare tregojnë se numri i personave që kanë hyrë në Kosovë përmes transportit rrugor dhe ajror gjatë muajit korrik dhe gusht ka shënuar rritje. Sipas të dhënave të Policisë së Kosovës dërguar "Radios Evropa e Lirë", theksohet se derisa në muajin qershor numri i personave që kanë hyrë përmes transportit rrugor ka qenë 1.858,533, në muajin korrik është rritur për



1.032,318.

Ndërsa vetëm brenda 15 ditëve të muajit gusht në Kosovë kanë hyrë 1.409,502 persona. Në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari" numri i udhëtarëve në muajin korrik ishte 340.446. Krahasuar me periudhën e njëjtë kohore të vitit 2019, ka pasur rritje për 60.433 udhëtarë. Në 15 ditë të muajit gusht janë realizuar 738 fluturime me 91.634 udhëtarë.

Rriten të hyrat tatimore dhe doganore

Se ekonomia e Kosovës ka shënuar rritje ka theksuar edhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti.

Duke bërë një krahasim me vitin e kaluar, Kurti ka thënë se vetëm në tremujorin e dytë të këtij viti qarkullimi i bizneseve ka shënuar rritje për 46 për qind. Ky krahasim ka hasur në reagime nga opozita. Ish-ministrja e Financave nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Hykmete Bajrami, thekson se nuk bëhen krahasime me vitin e kaluar kur vendi ishte i mbyllur për shkak të pandemisë. "Normalisht se ka 37 për qind më shumë TVSH të mbledhur se vitin e kaluar, sepse vitin e kaluar vendi ka qenë i mbyllur. Normalisht se ka 95 për qind më shumë tatim në pronë të mbledhur këtë vit, sepse vitin e kaluar qytetarët, për shkak të mbylljes, as që kanë pasur mundësi ta paguajnë tatimin në

pronë", ka shkruar Bajrami në rrjetin social "Facebook". Megjithatë, nëse të dhënat krahasohen edhe me vitin 2019, shihet se ka pasur ngritje të hyrave që mbledhen brenda vendit dhe në kufi. Sipas të dhënave të Administratës Tatimore të Kosovës, në gjashtëmujorin e parë të vitit të vitit 2019 të hyrat tatimore në Kosovë kanë qenë në vlerë prej 239.5 milionë eurosh, ndërsa në vitin 2021 totali i të hyrave kap vlerën e 290.3 milionë euro. Edhe të dhënat e Doganës së Kosovës tregojnë se ka pasur rritje të të hyrave. Derisa në periudhën janar-korrik 2019 të hyrat ishin 613 milionë euro, në periudhën e njëjtë të këtij viti të hyrat janë 740 milionë euro.

Ministri Peci merr pjesë në konferencën ndërkombëtare ministrore në Slloveni

PRISHTINË, 20 GUSHT (ER) - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci, po merr pjesë në konferencën Ndërkombëtare Ministrore me temën "Gratë dhe pozicioni i tyre në zonat rurale", e cila është duke u mbajtur në Brdo afër Kranjit të Sllovenisë.

Gjatë kësaj konference dyditore, ministri Peci ka mbajtur edhe një fjalim, ku ka prezantuar para pjesëmarrësve politikave bujqësore të Qeverisë së Kosovës, ku ka theksuar se gjatë këtij mandati do të angazhohen që përmes mekanizmave shtetërorë, avancimit të legjislacionit aktual, si dhe politikave zhvillimore të krijojnë kushte më të favorshme për avancimin e grave në sektorin e bujqësisë, si dhe për lehtësimin e procedurave në këtë fushëveprimtari. "Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe

Zhvillimit Rural, në kuadër të programeve mbështetëse për sektorin, aplikon kriteret stimuluuese apo pikë shtesë për gratë fermere ose pronare të bizneseve në zonat rurale. Kjo ka ndikuar në rritjen e numrit të aplikuesve dhe përfituesve gra në zonat rurale nga Programi për Zhvillim Rural, megjithatë ka vend për përmirësim. Po ashtu, jemi në proces të hartimit të Strategjisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural për periudhën 2021-27 në të cilën do t'i kushtohet rëndësi e veçantë kësaj dhe kontributit të gruas në bujqësi dhe agro-përpunim, duke qenë se në Kosovë kemi gra ndërmarrëse të cilat, edhe përkundër vështirësive, janë histori suksesi", ka theksuar në fjalimin e tij ministri Peci.


Gjatë kësaj konference ministrat e bujqësisë të vendeve anëtare të BE-së, vendeve



kandidate dhe kandidatëve potencialë për praninë në BE, gjatë diskutimeve që do të kenë,

do të shkëmbejnë praktikën më të mira të politikave përkrahëse përmes të cilave kanë arritur

avancimin e veprimtarive bujqësore të grave fermere në zonat rurale.



'Lamtumirë Gabo dhe Mercedes' – Dashuria në kohërat e famës

Kujtimet e të birit për humbjen e prindërve të tij dhe fundin e një epoke në letërsinë kolumbiane

Nga Boyd TONKIN
Wall Street Journal

Mercedes Barcha-s i pëlqente t'u rikujtonte dy djemve të saj që "ne nuk jemi figura publike". Burri i saj këmbëngulte gjithmonë që "çdokush ka tri jetë: atë publike, private, dhe të fshehtë". Fëmijët e tyre u rritën në një shtëpi ku "vija mes publikes dhe private" ruhej rreptësisht. Sidoqoftë, Rodrigo Garcia, djali i madh i Mercedes-it dhe Gabriel García Márquez-it, tashmë ka shkruar një kujtim të hollë, personal mbi ditët e fundit të një prej çifteve letrare më të njohura të planetit.

Laureati kolumbian i Nobelit i cili shkroi "Njëqind vjet vetmi", "Dashuria në kohërat e kolerës" dhe vepra të tjera që rikonturuan edhe hartën kulturore të Amerikës Latine dhe konturet e trillimit modern, vdiq në shtëpinë e tij në Mexico City në Prill 2014. Ishte 87 vjeç. Pas një miqësie të gjatë, ai u martua me Mercedes Raquel Barcha Pardo në Barranquilla në 1958. García Márquez pohon se e ka takuar fillimisht rreth 1941 kur ajo – po ashtu si ai, fëmija i një farmacisti nga qytetet përvëlues të bregut të lumit Magdalena – ishte 9 vjeç dhe ai 14. Në fillimet e 1945, ai kompozoi një sonet për nxënësen me prejardhje pjesërisht egjiptiane të cilën e

lëvdoi si "herët në mëngjes / po aq e pabesueshme sa çdo histori".

Martesa do të vononte më shumë se një dekadë: Bashkimi i tyre do të zgjaste deri në vdekjen e tij. Për Gerarld Martin, biografi i autorizuar i Gabriel García Márquez, Mercedesi i solli "freski dhe metodë jetës së tij" dhe i imponoi "ndjenjën e saj legjendare të rendit" në punëtorinë e tij krijuese. Ajo vetë vdiq në gusht 2020. Vdekja e saj e shtyu Rodrigo Garcia-n, lindur në 1959 në Bogotá (kryeqytetin gri, malësor e me shi të Kolumbisë, të cilin babai i tij karaibian e kishte kaq shumë inat) që të shkruante për prindërit e tij. Ose më mirë, të evokonte javët e fundit të babait të tij si një invalid i goditur nga kanceri, me kujtime joshëse mbi të kaluarën e tyre të përbashkët.

Z. Garcia është një shkrimtar-regjisor-producent i bazuar në Los Angeles: Veprat e tij përfshijnë filmat "Albert Nobbs" dhe "Last Days in the Desert" si dhe serialin e HBO-së "In Treatment". Në shtyp, ai paraqet skena të shkurtra, nga afër, të një shtëpie të zënë të një burri duke vdekur, të mbushur me kujdestarë dhe familjarë. Zëri i z. Garcia mbetet i butë dhe modest, sytë e tij të qëndrueshëm, stili i tij

mrekullisht pa zbulime. Ai vështron më shumë seç reflekton. Vetëm një episod të kujton paksa atmosferën e ethsme, ekstravagante dhe të çuditshme të trillimeve më të njohura të babait të tij, kur një zog përplaset me murin prej xhami të verandës. Ogur i mirë apo i keq? Stafi i shtëpisë nuk bie dot dakord. Sidoqoftë, trupi i tij i pajetë bashkohet me një papagall dhe një këlysh në ngastrën e varrezave të kafshëve për të cilën romancieri i përndjekur nga vdekja nuk dinte gjë (ai "do të ishte shqetësuar prej kësaj").

Gerald Martin e pa ngurrimin e hekurt publik me të cilin "Gabo" dhe Mercedesi ruanin martesën e tyre si "një lojë e luajtur mes dy njerëzve shumë të fortë, shumë ironikë dhe shumë privatë." Dashuria e tyre jetëgjatë shfaqet rrallëherë në kujtimet "Jeto për ta treguar" që García Márquez botoi më 2002 (në shqip: Onufri, 2016), pas një periudhe të vështirë me kancerin. Edhe ndërkohë që ai sheh babain e tij tek merr lejen e fundit, z. Garcia përpiqet të respektojë privatësinë e tyre. Nuk marrim exposé spektakulare por pak shkrepte devijuese, ndërkohë që Gabo i bën një tribut të papritur Elton John-it (atij "boleristi të pabesueshëm") ose bën shaka me infermieret e mbledhura "No me las puedo tirar a todas"

(S'mund t'ju palloj dot të gjithave). Z. Garcia përpiqet t'i shmanget "tundimit për të rritur famën vetjake në kohën e vulgarizimit", ndërkohë që kamerat grupohen në derën e jashtme. "Duhet të jemi të përgatitur pasi do të jetë si në kopsht zoologjik," paralajmëron Mercedesi Rodrigon. Është – megjithëse miqësor.

Nëse portreti fragmentar i të birit për Gabo-n zbulon pak gjë, Mercedes-i – "e hapur dhe e fshehtë, kritike dhe shpirtmadhe, por që i druhej rrëmujës" – na shfaqet në intervale nga pas maskës së kompetencës të çeliktë e të shkathët që gjen dhe në përshkrime të tjera. Një skenë nga dasma e saj tregon pasigurinë e hershme: Mercedes-i nuk u vesh derisa Gabo arriti në kishë, "që të mos kishte shans të braktisej në altar e veshur me fustanin e nusërisë".

"Lamtumirë Gabo dhe Mercedes" godet notën e tij të trishtimit jo falë ndonjë dramaticiteti në shtratin e vdekjes – Gabo ndërron jetë qetësisht dhe në heshtje. Përkundrazi, shqyrtimi pas fakteve i z. Garcia mbi punën e vështirë të vdekjes e lejon peshën e humbjes të mblidhet thujse pa u parë derisa bie si një gur mbi të mbijetuarit. Pasi vdes Gabo, Mercedes hyn në dhomë për të marrë punët në

dorë, si përherë, por shikon në fytyrën e të "pobrecito" (shkretit) dhe, siç nuk bën kurrë, qanë pak. Lotët e saj të menjëhershëm kanë forcën e breshërisë së një automatiku". Nuk ka asgjë tragjike për këtë vdekje të parathënë të një 87-vjeçari të nderuar i cili ka shijuar "një nga jetët më fatlume dhe më të privileguara të jetuara ndonjëherë nga një latino-amerikan" – përveç mungesës së tij të plotë. "Qué barbaridad," vajton agentja e tij e përkushtuar, Carmen Balcells. Çfarë barbariteti, vërtet, që një mendje e tillë të shuhet ndonjëherë. Kur e ndjek nga pas dhe Mercedes-i, z. Garcia e lidh vdekjen e prindit të dytë më zhdukjen e një planeti nga qielli. ("Ai është zhdukur, bashkë me fenë, shprehinë, zakonet dhe ritualet e tij të veçanta, të mëdha apo të vogla.") Lexuesit e rinj të Gabriel García Márquez-it ndonjëherë vijnë te librat e tij në kërkim të ekzotikes, fantastikes, të huajës. Ata qëndrojnë për të njerëzishmen, intimen, universalen. Po kështu, "Lamtumira" e z. Garcia, të prek kur del butësisht nga jeta publike në atë private për të na treguar mbylljen e njohur të kësaj bashkëjetese unike. Sa për jetën sekrete, e cila banon diku tjetër – e sigurt në artin e pakrahasueshëm të babait të tij.

Përktheu E. H.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Sot fillon edicioni i ri në futboll

Tri ndeshjet e javës së parë në Superligën e Kosovës në futboll zhvillohen sot (e shtunë), ndërsa dy të tjera zhvillohen nesër (e diel). Fituesja e Kupës dhe Superkupës luan ndaj Ulpianës, ndërsa kampionët e Prishtinës i shkojnë Malishevës

“Epoka e re”

PRISHTINË, 20 GUSHT - Edicioni i ri 2021/22 në Superligën e Kosovës në futboll fillon sot (e shtunë) me tri ndeshje mjaft interesante.

Nënkampionia në fuqi, Drita, e pret në Gjilan skuadrën e Feronikelit. Duke parë lëvizjet gjatë verës në afatin kalimtar, Drita është favorite absolute për faktin se ka bërë transferime mjaft cilësore, në anën tjetër Feronikeli

ka transferuar 13 futbollistë, por duket se ata nuk pritet të luajnë për shkak se “Niklit” i është holluar merkato si pasojë e moskryerjes së obligimeve ndaj futbollistit Alban Pnishi. Ndeshje tjetër interesante pritet

të zhvillohet në stadiumin “Bajram Aliu” në Skenderaj, ku Drenica e pret Gjilanin. Kjo e fundit me trajnerin Ismet Munishi kanë bërë shumë transferime dhe synojnë titullin, prandaj starti me një fitore si mysafir ka vlerë të madhe. Në anën tjetër, në krye të kuqezinjve është rikthyer trajneri Tahir Lushtaku, derisa nuk kanë munguar edhe shumë ndryshime në radhët e

futbollistëve. Në ndeshjen e tretë fituesi i Kupës dhe Superkupës, Llapi, e pret Ulpianën që debutojnë në Superligë. Të dielën zhvillohen dy ndeshjet e tjera, ku Malisheva e inkuadruar për herë të parë në histori në rangun elitare e pret skuadrën kampione, Prishtinën. Ndërsa në Suharekë, Ballkani do të përballet me skuadrën e Dukagjinit që, po ashtu, është rikthyer në Superligë.



Kosova dhe Shqipëria mësojnë kundërshtarët për parakualifikimet e ‘Eurobasket 2025’

GROUP A	GROUP B	GROUP C
1. Cyprus	1. Albania	1. Norway
2. Austria	2. Luxembourg	2. Kosovo
3. Switzerland	3. Romania	3. Denmark
4. Ireland		

PRISHTINË, 20 GUSHT - Në Gjermani është hedhur shorti për parakualifikimet e “Eurobasket 2025”. “Dardanët” janë në grup me Norvegjinë dhe Danimarkën. Gjithsej ishin dhjetë shtete, ku në një grup janë katër kombëtare dhe në dy grupet e tjera nga tri kombëtare. Kombëtares lidere

do të kualifikohen në rrethin e ardhshëm, si dhe vendi i dytë më i mirë në të tre grupet. Në grupin me katër shtete vendit të dytë nuk do t'i llogariten rezultatet nga ndeshjet me vendin e fundit. Kosova do të zhvillojë dy ndeshje në shtëpi dhe dy mysafire. Takimet zhvillohen në ditaret më 25-28

nëntor 2021, 24-27 shkurt 2022 dhe 30 qershor-3 korrik 2022. Në short ka qenë i pranishëm drejtori i përfaqësuesve të Kosovës, Granit Rugova. Edhe Shqipëria i ka mësuar kundërshtarët. Kuqezinjtë bëjnë pjesë në Grupin B, ku janë edhe Romania dhe Luksemburgu.

Ramadani dhe Kërçeli vazhdojnë bashkëpunimin me Prishtinën

Prishtinë, 20 gusht - Skuadra kampione në fuqi e Kosovës në futboll, FC Prishtina, ka vazhduar bashkëpunimin me trajnerin Zekirija Ramadani dhe drejtorin sportiv Fisnik Kërçeli. Ramadani dhe Kërçeli do të jenë pjesë e skuadrës kryeqytetase edhe për dy vjet të tjera. “Trajneri kampion Zekirija Ramadani dhe drejtori sportiv Fisnik Kërçeli kanë vazhduar

bashkëpunimin me klubin tonë edhe për dy vjet, pas suksesit të aritur në kampionatin vendor, duke e rikthyer në kryeqytet pas tetë vjetëve titullin kampion 2020/2021 dhe Superkupën e Kosovës 2019/2020, ndërsa drejtori Kërçeli ishte me skuadrën edhe me rastin e triumfit në Kupën e Kosovës 2019/2020, pa harruar edhe suksesin më të

madh në histori të klubit dhe futbollit të Kosovës, duke u plasuar në garat evropiane deri në UEFA Conference League, raundi i 3-të (përfshirë triumfin në eliminatore të Champions League ndaj kampionit të San Marinos dhe Andorrës dhe duke e mposhtur në UECL kampionin e Uellsit), thuhet në njoftimin e skuadrës së Prishtinës.



Superliga e basketbollit fillon me derbi

PRISHTINË, 20 GUSHT - Është hedhur shorti për edicionin e ri në Prince Caffè Superligën e Kosovës në basketboll. Edicioni i ri do të fillojë në mesin e muajit shtator. Ky edicion pritet të jetë shumë interesant, kurse nuk mungojnë ndeshjet interesante që nga java e parë, ku

përballen Prizreni 16 dhe Rahoveci, ndërsa kampioni Golden Eagle Ylli në xhiron e parë përballët me Trepçën. Skuadra e inkuadruar në elitë, Drita, ndeshet me Sigal Prishtinën, kurse çifti i fundit është Peja - Bashkimi. Rivalët e vjetër, Peja dhe Sigal Prishtina, do të

përballen në javën e dytë. Edicioni i ri do të nisë me Final 8 Superkupa, ku marrin pjesë tetë skuadrat e elitës nga 1 deri më 5 shtator. Në xhiron e parë takohen: Trepça-Golden Eagle Ylli, Prizreni 16-Rahoveci, Drita-Sigal Prishtina, Peja-KB Bashkimi.



Reja: Pres konfirmime nga Kombëtarja, shqiptarët më duan

TIRANË, 20 GUSHT - Kombëtarja shqiptare për pak ditë do të nisë grumbullimin në prag të tri sfidave të rëndësishme në eliminoret e Botërorit "Katar 2022". Kuqezinjtë përballen me Poloninë në transfertën e 2 shtatorit, më pas presim Hungarinë dhe San Marinon. Trajneri i kombëtares shqiptare, Edoardo Reja, shpreson që përfaqësuesja shqiptare të nisë një seri rezultatesh pozitive dhe ta konfirmojë progresin e arritur në edicionin e fundit të Nations League. Në një intervistë dhënë për gazetën prestigjioze "Gazzetta dello Sport", tekniku i njohur ka komentuar zhvillimet në Serinë B italiane si dhe ka folur për objektivat e Shqipërisë në këto eliminatore dhe thekson se pret një seri rezultatesh pozitive nga skuadra. "Javën e ardhshme do të kthehem në Shqipëri. Për mua është një aventurë shumë e bukur dhe shqiptarët më duan. Edhe këtu në Grado, ku ndodhem për të kaluar disa ditë plazh, kam takuar shumë



shqiptarë që jetojnë në Itali dhe më kanë komplimentuar për rezultatet e arritura me kombëtaren kuqezi. Aktualisht po punojmë në disa drejtime njëkohësisht. Së bashku me bashkëpunëtorët kemi organizuar disa kurse për formimin e përgatitësve atletikë dhe mjekëve sportivë. Një risi absolute për futbollin në Shqipëri. Përveç këtyre, përpara kemi ndeshjet për

eliminoret e Botërorit 'Katar 2022' ndaj Polonisë, Hungarisë dhe San Marinon", ka thënë Reja. "Nga këto ndeshje pres nga skuadra konfirmime të progresit që kemi arritur gjatë edicionit të fundit në Nations League. Në pritje të sfidës së kthimit me Anglinë, objektivi ynë është që të shkojmë në këtë duel të motivuar nga një seri fitoresh e rezultatesh pozitive", ka shtuar Reja.

Harden: Duam titullin, ja pse dështuam sezonin e fundit

BROOKLYN, 20 GUSHT - Ekipi i Brooklyn Netsit konsiderohej favorit kryesor për fitimin e titullit kampion në NBA sezonin e kaluar. Në përbërje të kësaj skuadre ishin 3 yje: Kevin Durant, Kyrie Irving dhe James Harden. Gjithsesi, problemet e shumta me dëmtimet që pati kjo skuadër bënë që objektivi i titullit të dështojë. James Harden, i njohur me nofkën "Mjekra", duke folur për sezonin e tij të parë me Nets, ka thënë: "E konsideroj pozitiv. Unë erdha në mes të sezonit, Durant ishte i dëmtuar, masat anti-Covid, problemet fizike të Irving. Të gjithë këto ndikuan te loja e skuadrës. Gjithsesi, tani kemi një sezon të tërë përpara për të arritur aty ku dëshirojmë. Uroj që të mos kem probleme fizike si vjet, që më penalizuan shumë. Ende jam duke u përpjekur të gjej formën më të



mirë. Dëmtimi në gju ishte i rëndë, qëndrova në pushim disa muaj, ndaj dua të jem në formë kur të nisë sezoni i ri. Rehabilitimi po shkon mirë. Nëse jemi në formën tonë më të mirë, nuk na ndal dot askush.

Jemi të përqendruar dhe e dimë se çfarë duhet të bëjmë për të qenë në majë. E rëndësishme është të jemi të gjithë në formë. Mezi presim të luajmë të gjithë bashkë një sezon të tërë", ka deklaruar Harden.

SHKURT

Ramadani përfundoi i shtati në Kampionatin Botëror U-20

Muhamet Ramadani ka zënë vendin e shtatë në hedhjen e gjyës 6 kg në Kampionatin Botëror U-20 të atletikës që po mbahet në Nairobi të Kenisë. Atleti i Kosovës në gjashtë tentimet e finales, hedhjen më të mirë e pati 18.97 metra. Vendin e parë e zuri kubanezi Juan Gomez, me 19.73 metra. Ramadani nuk arriti ta përsërisë rezultatit 19.92 m të arritur një muaj më parë, kur u bë kampioni i Evropës për U-20. Sipas trajnerit të tij, Shaban Ramadani, kushtet klimatike bënë që Muhameti të mos arrijë rezultat më të mirë.

Arsenali transferon Odegaardin për 35 milionë euro

Arsenali ka konfirmuar transferimin prej 35 milionë eurosh të Martin Odegaard nga Real Madridi. 22-vjeçari bëri përshtypje pozitive në 20 paraqitjet e tij për "Gunners" nga fundi i janarit e tutje, shkruan "Daily Mail". Odegaard mungoi në stërvitjen e Real Madridit dhe tani Arsenali ka konfirmuar nënshkrimin. Repreruesi norvegjez mund ta bëjë debutimin e tij në derbin e Londrës kundër Chelseat të dielën. Transferimet e Arsenalit në këtë afat kalimtar janë Ben White, Nuno Tavares dhe Albert Sambi Lokonga.

Benzema, në Real deri më 2023

Real Madridi e ka rinovuar kontratën me sulmuesin Karim Benzema. 33-vjeçarit i skadonte kontrata verën tjetër, por ka firmosur dhe për një vit tjetër dhe tanimë kontrata e re do të skadojë në vitin 2023. Benzema është një ndër lojtarët më të rëndësishëm të Realit duke marrë edhe shiritin e kapitenin. Sulmuesi u transferua në vitin 2009 nga Lyoni duke u bërë shënuesi i pestë më i mirë në historinë e madrilenëve me 281 gola në 12 vjet. Lajmi u dha nga vetë faqja e klubit duke marrë pëlqimin e shumë tifozëve të cilët që pas largimit të Ronaldos tri vjet më parë, e kanë parë Benzeman si liderin e ekipit.

Capello: Interi është favorit për 'Scudetto'

Sezoni i ri 2021/22 në Serinë A do të fillojë të shtunën. Kampion aktual është Interi, që hyn në edicionin e ri me shumë ndryshime në ekip. Edhe skuadra të tjera të mëdha si Juventus dhe Milan kanë bërë disa ndërhyrje në merkato. Sipas trajnerit të njohur italian Fabbio Capello, 'nerazzurët' mbeten favoritë për ta fituar sërish titullin. "Juventusit me Max Allegri do të gjejë sigurinë, por Interi mbetet skuadra më e fortë, ka shitur lojtarë të rëndësishëm, por 'baza' e skuadrës ka mbetur aty. Simone Inzaghi do të duhet të bindë lojtarët se kampionatin nuk e kanë fituar vetëm Conte dhe Lukaku", ka thënë Capello.

Mourinho: Të dashurat e lojtarëve do të mërziten me mua

AS Roma arriti një fitore të vështirë në Conference League ndaj Trabzonsporit me shifrat 2-1. Pas ndeshjes, për mediat foli trajneri Jose Mourinho, i cili foli edhe për merkaton dhe objektivat e ekipit. Portugezi "qau" largimin e Dzekos dhe dëmtimin e Spinazzolas, të

cilët është dashur t'i zëvendësojë në merkato. Mourinho do tituj, por paralajmëron edhe humbje në këto fillime të tij te Roma. "Skuadra do të flejë në Trigoria nga sonte për të përgatitur më pas ndeshjen me Fiorentinën. Ndoshta të dashurat e

lojtarëve nuk do të jenë të kënaqura për zgjedhjen time, por mendoj se është e drejtë ta bëj këtë sepse pushimet kanë mbaruar. Futbolli luhet për të fituar tituj dhe jo vetëm për t'u argëtuar. Sezonin e shkuar ishim larg majës. Këtë verë klubi bëri një merkato

reaguese, diçka që nuk ishte parashikuar, duke parë dëmtimin e Spinazzolas dhe largimin e papritur të Dzekos. Diçka mungon, por shpresoj të vijë. Në këtë sezon do të vijmë disa humbje, por ne gjithmonë do të luajmë për të fituar", u shpreh Mourinho.

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Abrrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553
PRISHTINË

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook www.facebook.com/gjejpuneshpejte

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Sara Pruthi shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës së mesme si dhe diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë "Dr. Ali Sokoli" Prishtinë.

► "Phone Calls" shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 70588307.

► Shkumbin Hetemi B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811541037.

► D.P.Z. "Drini i Bardh" shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 80199082 si dhe nr. fis: 600480305.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

